

08.11.2024

**AKT - THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE**  
**“Comandante Marcos AL” SH.P.K**

**Neni 1- FORMIMI**

Themelohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “**Comandante Marcos AL**” Sh.p.k me Ortake Shoqerine e te drejtës kosovare Comandante Marcos LLC dhe shoqërinë e te drejtës shqiptare Soma Albania shpk.

**Neni 2 - SELIA**

Shoqeria Tregtare “**Comandante Marcos AL**” Sh.p.k. e ka seline ne: Nj.A. nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, P. Hekla, nr. 31, Tirane.

**Neni 3 - KOHEZGJATJA**

Shoqeria Tregtare “**Comandante Marcos AL**” Sh.p.k. ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike me afat te pacaktuar.

**Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqëria ka si objekt veprimtarie:

- Restorant, bar, bufe dhe shërbime te ngjashme;

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë, direkt dhe indirekt, të gjitha aktivitetet që përfshihen në objektin e saj si dhe të gjitha aktivitetet plotësuese që lidhen me të; të ndërmarrë të gjitha operacionet tregtare, industriale, ato që lidhen me pasuritë e tundshme, ato të patundshme dhe pasuritë financiare që lidhen me objektin e vetë shoqërisë. Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen në përputhje me ndalimet, kufizimet, kushtet dhe autorizimet e parashikuara në ligj dhe në Statut.

**Neni 5 - KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare “**Comandante Marcos AL**” Sh.p.k eshte 100 leke (njëqind), i cili do te shlyhet i gjithi nga Ortaket e Shoqerise. Kapitali perbehet nga 2 kuota.

**Neni 6 - Administratoret**

Shoqeria Tregtare “**Comandante Marcos AL**” Sh.p.k. ka si Administrator te saj:

- z. Shkelqim Qausi, shtetas kosovar, lindur me 31.12.1978, ne Gjakove dhe banues ne Gjakove, Kosove, mbajtës i letërnjoftimit kosovar me nr. ID0510637 dhe nr. personal 1003321262

Administratoret mund te japin dorëheqjen ose te revokohen nga shumica e ortakeve ne cdo moment.

Administratoret do te ushtrojnë te gjitha kompetencat e administrimit te përcaktuaranga dispozitat ligjore ne fuqi.

## Neni 7- SHIPERBERJA E SHOQERISE

Shperberja e Shoqerise Tregtare "Comandante Marcos AL" Sh.p.k. mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredolloj shkak. duke vepruar sipas kriterëve te parashikuara ne Statutin e Shoqerise.

### ORTAKE TE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Comandante Marcos AL" shpk

Shoqeria Comandante Marcos LLC  
Perfaqesuar nga  
Artan Kyçyku



Shoqeria Soma Albania shpk  
Perfaqesuar nga  
Gridens Qarri

